

  
**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS**  
**Drejtoria Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit të Burimeve Natyrore**  
**Drejtoria Minerare dhe Industriale**

---

**URDHËR**

Nr. 813, datë 17.10.2011

**PËR**

**SHPALLJEN E ANKANDIT PËR DHËNIEN E TË DREJTËS PËR SHFRYTËZIMIN  
E OBJEKTEVE TË MBETJEVE MINERARE TË ISH NDËRMARRJEVE  
SHTETËRORE MINERARE**

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 2, pika 39, të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010, "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë",

**URDHËROJ :**

1. Mbetjet minerare të përfshitura prej proceseve të shfrytëzimit të minierave apo nga proceset e përpunimit të mineraleve nga aktiviteti i ish-ndërmarrjeve shtetërore minerare, që ndodhen të depozituara mbi sipërfaqen e tokës në gjendje të ngurtë ose të lëngët, vlerësohen nga institucionet e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH) për mbetjet e ish ndërmarrjeve gjeologjike dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) për mbetjet e ish ndërmarrjeve minerare mbi bazën e informacioneve egzistuese dhe studimeve që realizojnë këto struktura përgjegjëse.
2. Vlerësimi i mbetjeve minerare përfshin:
  - a) sasinë e mbetjeve të depozituara,
  - b) sipërfaqen ku janë depozituar me koordinata në hartë me shkalle 1:25000 sipas koordinatave shtetërore në planin horizontal,
  - c) përbajtjen e elementeve të dobishëm në këto mbetje,
  - d) vlerën fillestare të ankandit për një ton mbetje nëse shfrytëzohen.
  - e) vlerën minimale të investimit që kërkohet të realizohet për objektin në ankand;
  - f) vlerën minimale të sasisë se mbetjeve që do të ripërpunohet për objektin në ankand;
3. Vlera fillestare e një ton/mbetje minerare për procedurën e ankandit përcaktohet mbi:

- a) Përbajtjen e elementeve të dobishëm në mbetjet minerare;
  - b) Tipin e elementeve të dobishëm që ndodhen në mbetjet minerare;
  - c) Efektivitetin e investimit
  - d) Rëndësinë e rehabilitimit të zonës minerare
  - e) Rëndësinë e eliminimit të efekteve negative në mjeshtëri mbetjet minerare
4. Mbetjet minerare të përfshitura nga aktiviteti i ish-ndërmarrjeve shtetërore minerare shiten nëpërmjet procedurave të ankandit dhe shfrytëzohen me leje minerare, sipas dispozitive të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010, "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë".
5. Të gjitha zonat ku janë të depozituara mbetjet minerare nga aktiviteti i ish-ndërmarrjeve shtetërore minerare publikohen, si zona konkuruese si shtesë e planit vjetor minerar dhe kalojnë në procedure ankandi.
6. Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energetikës është Autoriteti kontraktues.
7. Njësia e hartimit të dokumentacionit për organizimin e procedurave të ankandit, të përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë si më poshtë:
- a) Kryetar nga institucioni i METE
  - b) Një Anëtar nga institucioni i METE
  - c) Një Anëtar nga institucioni i AKBN
  - d) Një Anëtar nga institucioni i SHGJSH
  - e) Një Anëtar nga ndërmarrja që ka në inventar depozitën e mbetjeve minerare (ALBKROM, ALBBAKER, ALBMINIERA)
8. Njësia e hartimit të dokumenteve është përgjegjëse për:
- a) hartimin e dokumenteve të ankandit, kërkesave për kualifikim, kritereve të konkurrimit, kushteve të plotësimit të këtyre kritereve dhe kritereve të vlerësimit;
  - b) hartimin e regjistrat të ankandit për objektin konkret të mbetjeve minerare;
  - c) hartimin dhe dërgimin e njoftimeve;
  - d) mbledhjen dhe administrimin e dokumenteve të nevojshme, të cilat kanë të bëjnë me procedurën e ankandit;
  - e) detyra që i ngarkohen nga komisioni i vlerësimit të ofertave.
- Gjatë procesit të hartimit të dokumenteve, mbahet procesverbal, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e njësisë së hartimit të dokumenteve.
9. Numri i objekteve të mbetjeve minerare që do të hidhet në konkurrim në një procedurë konkuruese do të jepet në urdhrin përkatës të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energetikës për çdo ftesë oferte.
10. Personat anëtarë të njësisë se hartimit të dokumenteve për procedurën se ankandit nuk mund të emërohen anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave. Anëtarët e njësisë së hartimit të dokumenteve për procedurën e ankandit dhe çdo person që ka marrë pjesë në procedurën e hartimit të dokumenteve kanë detyrimin të ruajnë konfidencialitetin e përbajtjes së ofertës.
11. Drejtoria Përgjegjëse në METE që trajton problematikat e lejeve minerare mban regjistrin e ankandit për zonat e mbetjeve minerare. Ky regjistër ruhet dhe administrohet për një periudhë kohe një vjeçare dhe në përputhje me kërkesat e ligjit për arkivat. Regjistri i procedurave të ankandit përmban:
- a) emërtimin dhe adresën e autoritetit kontraktues;
  - b) zonën e depozitës së mbetjeve minerare të shpallur për ankand të paraqitur në hartë me shkallë 1:25000 sipas koordinatave shtetërore në planin horizontal dhe të dhënat për objektin e mbetjeve minerare në ankand;

- c) vlerën fillestare të ankandit për një ton mbetje nëse shfrytëzohen;
- d) vlerën përfundimtare të ankandit për një ton mbetje të subjektit fitues;
- e) vlerën minimale të investimit që kërcohët të realizohet për objektin në ankand;
- f) vlerën minimale të sasisë se mbetjeve që do të ripërpunohet për objektin në ankand;
- g) emrat e anëtarëve të njësisë së hartimit të dokumenteve të konkurrimit publik;
- h) emrat e anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave;
- i) emrat dhe adresat e ofertuesve;
- j) një përbledhje të vlerësimit dhe të krasimit të ofertave;
- k) një përbledhje të gjitha kërkesave për sqarim për dokumentet të ankandit dhe përgjigjen e tyre;
- l) një përbledhje të ankesave të bëra dhe zgjidhjes së tyre.

12. Komisioni i vlerësimit të ofertave përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë si më poshtë:

- |               |   |        |
|---------------|---|--------|
| 1. Kryetar    | nga institucioni i  | METE   |
| 2. Dy Anëtar  | nga institucioni i  | METE   |
| 3. Një Anëtar | nga institucioni i  | AKBN   |
| 4. Një Anëtar | nga institucioni i  | SHGJSH |
| 5. Dy Anëtar  | nga ndërmarrja që ka në inventar depozitën e mbetjeve minerare (ALBKROM, ALBAKER, ALBMINIERA) |        |

Në komisionin e vlerësimit të ofertave nuk mund të marrin pjesë:

- a) Personat që përbëjnë konflikt interes me ofertuesit sipas kuptimit të ligjit nr.9367, date 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”;
- b) Personat e kane lidhje gjaku, krushqie apo interes me ofertuesit në procedurë konkuruese;

Kryetari i komisionit është plotësish përgjegjës për organizimin e punës menjëherë pas krijimit të komisionit. Komisioni zbaton detyrat e tij në pavaresi të plotë dhe nëse kërcohët ndonjë sqarim në lidhje me dokumentet e procedurës konkuruese, këto merren nga njësia e hartimit të dokumenteve. Komisioni nuk kryen asnjë veprim tjetër, përvèç atyre të përcaktuara në VKM nr. 320, datë 21. 04. 2011 “Për miratimin e procedurave e të kritereve të konkurrimit dhe të afateve të shqyrtimit të kërkesave përmarrjen e lejeve minerare në zonat konkuruese” dhe VKM Nr.1719, datë 17.12.2008 “ Për miratimin e rregullave të ankandit publik”.

13. Kërkesat për kualifikim dhe dokumentet vërtetuese (originale ose fotokopje të noterizuara të lëshuara jo më parë se tre muaj nga dita e hapjes së ofertës) për plotësimin e kërkesave për kualifikim për të siguruar pjesëmarrje në procedurat e ankandit për një zonë mbetjesh minerare përfshijnë:

#### Kërkesat ligjore:

- a) Regjistrimi si person juridik vërtetuar nga Ekstrakti i regjistrat tregtar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit dhe NIPT-i;
- b) Dokumentet e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit që vërtetojnë se Ofertuesi:
  - i. nuk është në proces falimentimi,
  - ii. nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me nenin 45/1 të Ligjit për prokurimet publike
  - iii. nuk është dënuar me Vendim të Gjykatës së Formës së prerë, që lidhet me

### **aktivitetin profesional**

- c) Dokument që vërteton se kapitalet/asetet e subjektit tuaj nuk janë në duart e përmbaruesit gjyqësor apo ekziston një urdhër sekuestroje për to, lëshuar nga Zyra e Përmbarimit;
- d) Dokument që vërteton se subjekti ka plotësuar detyrimet fiskale dhe të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore, lëshuar nga Administrata Tatimore,

Shoqëritë ofertuese duhet të jenë të regjistruar në regjistrat përkatës profesionale ose tregtare të shtetit, në të cilin ato janë themeluar, duke vërtetuar personalitetin e tyre ligjor. Për ketë ofertuesit duhet të dorëzojnë një kopje të Ekstraktit mbi historikun e subjektit të lëshuar nga Qëndra Kombëtare e Regjistrimit. Ofertesi i huaj (shoqëri e regjistruar jashtë territorit të Shqipërisë) duhet të vërtetojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura me sipër. Nëse dokumentet e sipërpërmendur në pikat nuk lëshohen në shtetin e tyre të origjinës, atëherë ato do të pranohen në formën e deklaratës me shkrim, nën përgjegjësinë e ofertuesit. Nëse gjuha e përdorur në procedurë është shqip, atëherë dokumentet në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në shqip. Në rastet e bashkimit të përkohshëm të shoqërive, çdo anëtar i këtij bashkimi duhet të dorëzojë dokumentet e sipërpërmendur.

### **Kërkesat për Kapacitetet ekonomike dhe financiare.**

Ofertuesi duhet të ketë kapacitete dhe burime financiare të nevojshme për realizimin e planit të investimit në objektin e ankandit. Dokumentet që provojnë burime të mjaftueshme financiare të nevojshme për realizimin e investimeve të programuara për të zhvilluar veprimtarinë minerare si dhe/ose një nga vërtetimet për ekzistencën e tyre, përfshijnë:

- a) Një deklaratë nga Banka që konfirmon se personi juridik ka çelur numrin e llogarisë, ku të këtë të depozituara të paktën 20 % të vlerës së investimit të parashikuar për t'u realizuar në objektin e hedhur për ankandin e publikuar;
- b) Një dokument që vërteton se personi juridik ka siguruar një kredi prej një banke, ose subjekti tjetër financiar me vlerë, e cila mbulon investimet që parashikohen të kryhen;
- c) Një kontratë me një investitor, i cili garanton mbështetje financiare për realizimin e programit të investimit. Në këtë rast personi juridik duhet të paraqesë një dokument notarial, në të cilin shprehet vullneti i investitorit për të mbështetur këtë investim, si dhe dokumentet që provojnë burimet financiare të këtij të fundit (garanci bankare, ose bilancet ekonomike të shoqërisë, në të cilën investitori është pronar/aksionar i vetëm, ose aksionar i shumicës se zotërimit të aksioneve/kryesor maxhoritar).
- d) Vërtetime të xhiros vjetore të 3 (tre) viteve të fundit të lëshuara nga Autoritetet përkatëse, ku shoqëria ka selinë zyrtare. Vlera mesatare neto e fitimit të një viti financiar, referuar 3 (tre) viteve të plota financiare të fundit, me të madhe se 50 % e vlerës së investimit të parashikuar për t'u realizuar në objektin e hedhur për ankand.

### **Kërkesat për kapacitetin teknik dhe profesional**

- a) Subjekti të ketë realizuar më parë veprimitari minerare të vërtetuar nga referenca për përbushje të suksesshme të punimeve minerare të ngashme, të lëshuara nga një ent publik, ose privat, që tregon vlerën kohën dhe natyrën e punimeve të ekzekutuara, dhe/ose çfarëdolloj dokumenti tjetër që parashikon legjislacioni në

fuqi dhe që mund ta vërtetojë një gjë të tillë.

- b) Kualifikimet arsimore dhe profesionale të stafit përgjegjës për drejtimin e punimeve;
- c) Dëshmi mbi fuqinë mesatare punëtore të ofertuesit dhe numrit të stafit drejtues;
- d) Dëshminë e drejtuesit teknik;
- e) Nëse subjekti fillon këtë aktivitet për herë të parë, duhet të paraqesë:
  - i. Një përshkrim të aktivitetit të mëparshëm;
  - ii. Curriculum Vitae të stafit të tij, që do të punojnë për këtë veprimtar;
  - iii. Licencat profesionale që lidhen me ekzekutimin e punimeve të planit të investimit;
  - iv. Dëshminë e drejtuesit teknik.
  - v. Dëshmi të mjeteve, pajisjeve teknike në dispozicion apo që mund të vihen në dispozicion të ofertuesit për të realizuar planin e investimit;

14. Ofertuesit janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat për kualifikim të përcaktuara në këtë pikë. Në të kundërt, ato do të refuzohen si të papranueshme. Ofertuesi përballon kostot që lidhen me përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës së tij. Autoriteti Kontraktues nuk është përgjegjës për këto kosto. Oferta dhe të gjithë dokumentet, si dhe korrespondencia që lidhet me ofertën, e shkëmbyer ndërmjet Ofertuesit dhe Autoritetit Kontraktues duhet të përgatiten në gjuhën shqip. Materialet mbështetëse dhe literatura e printuar, që paraqitet nga Ofertuesi mund të jetë e shkruar edhe në një gjuhë tjetër që përdoret gjërësisht në tregtinë ndërkombëtare, me kusht që këto dokumente të shoqërohen me përkthimin e duhur në gjuhën shqipe, të fragmenteve përkatëse që kanë të bëjnë me kërkesat për kualifikim.

15. Kriteret e vlerësimit, dhe dokumentet vërtetuese për plotësimin e tyre plotësohen për pjesën e vlerës fillestare të ankandit, vlerës minimale të investimit, sasisë së përpunimit të mbetjeve minerare dhe vlerës së rehabilitimit të objektit të mbetjeve minerare për çdo objekt/zonë minerare nga njësia e hartimit të dokumenteve dhe më pas nga ofertuesi në ofertën e tij tekniko-financiare dhe janë si më poshtë:

#### Kriteret e ofertës teknike dhe financiare

<b>Kriteret teknike dhe financiare</b> për objektin ..... / e mbetjeve minerare nr. ..... shpallur si shtesë në planin vjetor minerar të vitit 2011, të përfshirë në qarkun e ..... <b>PËR LEJE MINERARE SHFRYTËZIMI</b>			
<b>Përshkimi i kriterit teknik</b>	<b>Kushti minimal i ofertës që përgatitet nga Njësia e hartimit të dokumenteve</b>	<b>Dokumenti i ofertuesit</b>	<b>Vlerësimi për kriterin teknik</b>
<u>Aftësítë tekniko profesionale të subjektit:</u> Curriculum Vitae i aktivitetit të shoqërisë; Referanca ku vërtetohet se subjekti ka realizuar më parë veprimtari minerare; Curriculum Vitae i stafit të shoqërisë që do të punojnë për këtë veprimtar; Kualifikimet arsimore dhe profesionale të stafit përgjegjës për drejtimin e punimeve dhe numrit të		Dokumentet e ofertuesit do të vlerësohen për: Eksperiencën në veprimtarinë minerare Efektiviteti në veprimtari të mëparshme minerare Përbërjen e stafit për veprimtarinë minerare Kualifikimet, certifikatat dhe licencat profesionale të stafit për veprimtarinë minerare; Eksperiencën e drejtuesit teknik	<b>15 pikë</b>

stafit drejtues; Licencat profesional që lidhen me ekzekutimin e punimeve të planit të investimit; Dëshmi të mjeteve, pajisjeve teknike në dispozicion apo që mund të vihen në dispozicion të ofertuesit për të realizuar planin e investimit; Dokumente të tjerë që vërtetojnë kapacitetet tekniko-profesionale të subjektit.		Kapacitetet e mekanikes për veprimtarinë minerare	
<u>Aftësitë ekonomiko-financiare të subjektit:</u> Kapaciteti financiar i shoqërisë sipas deklaratave bankare; Kapaciteti financiar që mund të siguroje shoqëria nga kreditimet, apo kompani të tjera vërtetuar nga dokumente notoriale apo letra mbështetëse kreditimi të bankave; Vërtetime të xhirove vjetore të kompanisë sipas bilanceve të miratuarar për kapacitetet e saj financiare. Dokumente që vërtetojnë investime të ngashme të suksesshme të kompanisë. Dokumente të tjerë që vërtetojnë kapacitetet ekonomiko-financiare të subjektit.		Dokumentet e ofertuesit	<b>15 pikë</b>
Sasia që mendohet të përpunohet nga mbetjet minerare çdo vit nga objekti i mbetjeve minerare do të jetë jo me pak se ...(.....) ton në vit.	Sasia minimale që kërkohet të përpunohet nga objekti i mbetjeve minerare do të jetë jo me pak se ...(.....) ton në vit.	Sasia minimale që kërkohet të përpunohet nga objekti i mbetjeve minerare do të jetë ...(.....) ton në vit.	<b>10 pikë</b>
<b>Përshkrimi i kriterit financiar</b>	<b>Kushti minimal i ofertës</b>	<b>Vlera e ofertuesit</b>	<b>Vlerësimi për kriterin financiar</b>
Vlera e pagesës për 1 (një) ton/mbetje minerare	Vlera e pagesës për 1 (një) ton/mbetje minerare me të cilin fillon ankandi është.....(....) lek.	Vlera e pagesës për 1 (një) ton/mbetje minerare është.....(....) lek.	<b>20 pikë</b>
Vlera e investimit që parashikohet për tu kryer në objektin e mbetjeve minerare	Vlera minimale e e investimit që parashikohet për tu kryer e mbetjeve minerare do të jetë jo më pak se.....(....) lek.	Vlera minimale e e investimit që parashikohet për tu kryer e mbetjeve minerare do të jetë .....(....) lek.	<b>15 pikë</b>

Vlera e investimit për planin e rehabilitimit të objektit të mbetjeve minerare	Nuk ka kriter minimal	Vlera e investimit për planin e rehabilitimit të objektit të mbetjeve minerare do të jetë .....(....) lek.	<b>15 pikë</b>
Vlera e rentabilitetit ekonomik (IRR=....%)	Nuk ka kriter minimal	Vlera e rentabilitetit ekonomik është (IRR=....%)	<b>10 pikë</b>

16. Një Ofertues duhet të paraqesë vetëm një ofertë tekniko-financiare për një zonë konkurruese. Ofertuesit janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në pikat 13 dhe 15 të këtij urdhri. Në të kundërt, ato do të refuzohen si të papranueshme. Të gjitha vlerat duhet të kuotohen në Monedhën Shqiptare (Lek), duke përfshirë edhe tatimet që zbatohen, por pa përfshirë TVSH. Nëse këto vlera kuotohen në një monedhë të huaj, atëherë ato duhet të kthehen në Lekë Shqiptare dhe kursi i këmbimit duhet të jetë ai i fiksuar nga Banka e Shqipërisë në ditën kur publikohet njoftimi i kontratës dhe duhet të ruhet në atë kurs këmbimi deri në skadimin e periudhës së vlefshmërisë së ofertës. Ofertat duhet të janë të vlefshme për 60 (gjashtëdhjetë) ditë që nga momenti i skadimit të afatit kohor për dorëzimin e ofertave. Periudha e vlefshmërisë së ofertës fillon që nga momenti i skadimit të afatit kohor për dorëzimin e ofertave.
17. Subjekti fitues aplikon për leje minerare shfrytëzimi për objektin e mbetjeve minerare sipas kërkesave të përcaktuara në VKM nr. 320, datë 21, 04, 2011 “Për miratimin e procedurave e të kritereve të konkurrimit dhe të afateve të shqyrtimit të kërkesave përmarrjen e lejeve minerare në zonat konkurruese”.
18. Subjekti fitues që është pajisur me leje minerare shfrytëzimi çdo vit në datën efektive të dhënies së lejes bën pagesën për sasinë e mbetjeve që parashikon të përpunojë të përllogaritur mbi bazën e sasisë së mbetjeve që kërkon të përpunojë shumëzuar me vlerën e një ton mbetje të ofertës se tij tekniko-financiare sipas ankandit të realizuar ku ai është përcaktuar si fitues.
19. Ofertat do të vlerësohen nga Komisioni i vlerësimit të ofertave në bazë të kritereve të përcaktuara në pikën 15 të këtij urdhri, dhe fitues do të konsiderohet ai ofertues që ka pikë më tepër në bazë të kritereve të vlerësimit. Metodologjia e vlerësimit të ofertës tekniko-financiare është si më poshtë:

#### Metodologjia e vlerësimit

<b>Kriteret teknike dhe financiare për objektin ....., .... /e mbetjeve minerare nr. .....</b> shpallur në planin vjetor minerar të vitit 2011, të përfshirë në qarkun e .....			
<b>PËR LEJE MINERARE SHFRYTËZIMI</b>			
<b>Përshtrimi i kriterit teknik</b>	<b>Vlera maksimale e pikëve për:</b>	<b>Vlerësimi në pikë</b>	<b>Formula e llogaritjes në pikë përvlerat e ofertuesve</b>
Aftësitë tekniko profesionale të subjektit	Nuk ka kriter minimal por jo me shume se 15 pikë	<b>15 pikë</b>	ATPi=Pikët sipas Komisionit të Vlerësimit të ofertave
Aftësitë ekonomiko-financiare të subjektit	Nuk ka kriter minimal por jo me shume se 15 pikë	<b>15 pikë</b>	AEFi=Pikët sipas Komisionit të Vlerësimit të ofertave
Sasia që mendohet të përpunohet nga mbetjet minerare çdo	<b>Vlerën maksimale të kriterit</b>	<b>10 pikë</b>	$P_i = \frac{P_i}{P_{max}} \times 10$

<b>vit nga objekti i mbetjeve minerare</b>			
<b>Përshtimi i kriterit finanziar</b>	<b>Vlera maksimale e pikëve për:</b>	<b>Vlerësimi në pikë</b>	<b>Formula e llogaritjes në pikë përvlerat e ofertuesve</b>
Vlera e pagesës për 1 (një) ton/mbetje minerare	<b>Vlerën maksimale të kriterit</b>	<b>20 pikë</b>	$VPag_i = \frac{VPag_i}{VPag_{max}} \times 20$
Vlera e investimit që parashikohet për tu kryer në objektin e mbetjeve minerare	<b>Vlerën maksimale të kriterit</b>	<b>15 pikë</b>	$VIN_i = \frac{VIN_i}{VIN_{max}} \times 20$
Vlera e investimit për planin e rehabilitimit të objektit të mbetjeve minerare	<b>Vlerën maksimale të kriterit</b>	<b>15 pikë</b>	$VP_i = \frac{VP_i}{VP_{max}} \times 10$
Vlera e rentabilitetit ekonomik (IRR=...%)	<b>Vlerën maksimale të kriterit</b>	<b>10 pikë</b>	$VRen_i = \frac{VRen_i}{VRen_{max}} \times 10$
<b>TOTALI I PIKËVE</b>		<b>100 pikë</b>	$Pt_i = \frac{ATPi + AEFi + Pi + Ppi + VPagi + VINi + VPi + VPeri}{VPagi + VINi + VPi + VPeri}$

**Ku:**

**Pt<sub>i</sub>** ————— *Pikët totale të llogaritura të ofertuesit (i)*

**ATPi** ————— Pikët që merr ofertuesi për aftësitë e tij tekniko-profesionale sipas vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të ofertave mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga ofertuesi.

**AEFi** ————— Pikët që merr ofertuesi për aftësitë e tij ekonomiko-financiare sipas vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të ofertave mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga ofertuesi.

**Pi** ————— Sasia që mendohet të përpunohet nga mbetjet minerare çdo vit nga objekti i mbetjeve minerare në objektin/zonën minerare nga ofertuesi

**VPag<sub>max</sub>** ————— Sasia maksimale që mendohet të përpunohet nga mbetjet minerare çdo vit nga objekti i mbetjeve minerare në objektin/zonën minerare

**VPeri** ————— Vlera e pagesës për 1 (një) ton/mbetje minerare që parashikohet për tu paguar nga ofertuesi

**VPag<sub>max</sub>** ————— Vlera maksimale e pagesës për 1 (një) ton/mbetje minerare që parashikohet për tu paguar

**VINi** ————— Vlera e investimit që parashikohet për tu kryer nga ofertuesi

**VIN<sub>max</sub>** ————— Vlera maksimale e investimit që parashikohet për tu kryer

**Vpi** ————— Vlera e investimit që parashikohet për tu kryer nga ofertuesi për planin e rehabilitimit

**Vp<sub>max</sub>** ————— Vlera maksimale e investimit që parashikohet për tu kryer për planin e rehabilitimit

**VRen<sub>i</sub>** ————— Vlera e rentabilitetit nga ofertuesi

**VRen<sub>max</sub>** ————— Vlera maksimale e rentabilitetit

20. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit të Burimeve Natyrore dhe institucionet e SHGJSH, AKBN dhe ndërmarrjet që kane në inventar depozitat e mbetjeve minerare (ALBKROM, ALBBAKER, ALBMINIERA).

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

